



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 44

Datë: 07. 07. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvij, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni ; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.43/2021.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ së:

3. Aktivitetet e ZRPPC së:

4. Këshillat e KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Novobërdë,

Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurës për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës për zgjedhjet lokale 2021,

Shqyrtimi dhe miratimi i shfuqizimit të vendimit nr. 42/2021, i datës 11.01.2021, për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesëve Jashtë Kosovës,

Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ nr. 02/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votimin Jashtë Kosovës.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së.

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.

7. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.43/2021

Kreshnik Radoniqi: Rendin e ditës e keni para vetës, a ka diçka lidhur me rendin e ditës...?

Burim Ahmetaj, propozojë një pikë për rend dite: Është fjala për “Aplikacionin” që mendoj që duhet të jetë pjesë e agjendës, pra është fjala për “Formularin për Aplikim” për votuesit jashtë vendit...

Në kontekst, miratohet rendi i ditës nga anëtarët...

Në vazhdim, miratohet edhe procesverbali nga mbledhja e KQZ-së, nr. 43/2021.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ së:

Burim Ahmetaj, tha se Sekretariati, në vijimësi të përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, në përputhje me planin operacional, është në fazën e plotësimeve të vendeve të paplotësuara si rezultat i verifikimit të kandidatëve dhe vendet që duhet të plotësohen nga shoqëria civile. Pas kompletimit të këtij aktiviteti, do të pasojë programi orientues për KKZ i cili do të

zhvillohet nga Divizioni i Trajnimit dhe përkrahet nga Departamentet tjera të Sekretariatit. Programi Orientues është duke u përgatitur, për tu zhvilluar, në javën e dytë të muajit korrik 2021.

Më 01 korrik 2021, është mbajtur takimi i përbashkët i Sekretariatit me Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve nga secila komunë, me qëllim të përkrahjes së ZLKZ-ve, koordinimin e aktiviteteve që ndërlidhen me terrenin, s'i dhe aspektet e trajnimit, logjistikës, nominimit të KVV-ve, zëvendësimet, si dhe pagesat e trupave zgjedhor.

Operacioni i votimit përmes postës, përkatësisht periudha e aplikimit për tu regjistruar si votues jashtë vendit, tha z. Ahmetaj, do të fillojë me datë 10 korrik 2021. Sekretariati, është duke u përgatitur për të zhvilluar operacionin në fjalë dhe hapësira ne të cilin do të vendoset ky shërbim, është në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës, në sallën B202. Aktualisht, operacioni i aplikimit është paraparë të zhvillohet vetëm në një ndërrim prej 08:00, deri në 16:00.

Para se të fillojë periudha e aplikimit për tu regjistruar, Sekretariati sipas procedurave do të dërgojë e-mail, të gjithë votuesve që kanë pasur të drejtë për të votuar jashtë vendi, të cilët duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen në zgjedhje dhe që duhet të plotësojnë një formular dhe kopjen e një dokumenti valid.

Sekretariati, tha z. Ahmetaj, është në prag të nënshkrimit të kontratës për Informimin Publik, ndërsa për fletëvotime, është në fazën e vlerësimit.

Aktivitete tjera që janë në proces: vlerësimi i Qendrave të Votimit, Plani i Sigurisë, Plani i vizitave nëpër Komuna, dizajnimi i formave zgjedhore, fletëvotimeve dhe broshurave se si do të duken.

Kreshnik Radoniqi: A ka dikush pyetje rreth këtij raport. Nëse jo, vazhdojmë...

3. Aktivitetet e ZRPPC së:

Yll Buleshkaj: Faleminderit. Në mes të dy mbledhjeve, zyra ka përgatitur raportin. Kemi përfunduar hartimin e procedurës standarde të mënyrës se si do t'i trajtojmë hap mbas hapi aplikacionet për certifikim dhe akreditim! Këto procedura, do të trajtohen në Këshillin për Çështje Ligjore...

S'i zyre, kemi vëzhguar Konventën e partisë PDK, dhe se nuk kemi vërejtur ndonjë gjë që është zhvilluar jashtë kornizës ligjore...

Po ashtu, tha z. Buleshkaj, jemi në kontakte me partitë që duan të certifikohen për zgjedhjet. Për rrjedhojë, kemi pranuar edhe kërkesën e dytë për certifikim, që vjen nga një kandidat i pavarur nga komuna e Kaçanikut...

4. Këshillat e KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Novobërdë,

Florian Dushi: Këshilli në dy takimet e fundit, ka bërë gati për KQZ disa çështje. Sot, e kemi edhe Formularin...

E para, kemi kërkesën zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Novobërdës. Kemi shqyrtuar dosjen, dhe rekomandojmë që Radovan Deniq, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Novobërdë, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Predrag Stojkoviqin.

Alim Rama: E lexova arsyetimin ndërkohë, ne e kemi pasur një vendim të Gjykatës Kushtetuese që e obligon KQZ-së që zëvendësimet të jenë sipas kuotës gjinore, pra që e lejon kjo, dhe se a është respektuar ky kriter...? Nuk po e shoh nëse, ky vendim është zbatuar...Pra, a ka pasur tejkalim...?

Florian Dushi, tha se sipas numrit të votave, i radhës ka qenë z. Deniq.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurës për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës për zgjedhjet lokale 2021:

Florian Dushi, tha se në këshill jemi marrë vesh që ky të jetë një njoftim dhe një konfirmim nga KQZ, sepse ky është një vlerësim që ka të bëjë me procedurën e kritereve “të zotësisë juridike për fitimin e të drejtës së votës në këto zgjedhje”. Dhe është një procedurë standarde e cila, nuk ndryshon sepse nuk kemi pasur ndryshim të legjislacionit zgjedhorë...

Prandaj, e njëjta është sjellë s'i njoftim se, kjo do të publikohet në ueb faqe, ku janë të përmbledhur informacionet e nevojshme...

Një çështje tjetër që është ngritur, dhe unë po ia përkujtoj Sekretariatit që e ka marrë për obligim me e zbatuar, është edhe “e drejta” e shtetasve që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës dhe të njëjtit i posedojnë ende dokumentet valide...Dhe se, nga Sekretariati kemi kuptuar që në fakt, personat që heqin dorë nga shtetësia, të njëjtit i posedojnë dokumentet...

Ndërkohë, tha z. Dushi, ata mund të votojnë por të njëjtit nuk e përmbushin kushtin kryesor kushtetues, dhe se kemi kërkuar nga Sekretariati që në komunikim me MPB-në, do të shohim nëse mund ta kemi listën e këtyre personave...dhe atyre, të mos ju lejohet e drejta e votës...

3. Shyqrtimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ nr. 02/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votimin Jashtë Kosovës:

Florian Dushi: Rekomandim tjetër, është shfuqizimi i vendimit nr.42/202 i datës 11. 01. 2021 që ka të bëjë me verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për periudhën për aplikim të votuesve Jashtë Kosovës. Ne, e dimë që KQZ, për të siguruar integritetin zgjedhor ka marrë një vendim të këtillë në të kaluarën, nga ajo se çfarë ka prodhuar “ky verifikim” në zgjedhjet e fundit, kemi parë se nuk është një dukuri e përhapur, domethënë pjesa e aplikimit sikur ishte në zgjedhjet në Istog...prandaj, edhe nga pjesa e mësimave të nxëna, ka ardhur në shprehje shfuqizimi i këtij vendimi...bashkë me ndryshimet tek Udhëzimi Administrativ 01/2021 i cili, po ashtu sqaron procedurat se si do të bëhet verifikimi i aplikacioneve....

Si këshill: prandaj rekomandojmë të shfuqizohet, sepse si këshill kemi konstatuar se verifikimi nuk është i nevojshëm të bëhet tek të gjitha rastet e aplikuesve për votim nga jashtë, por thjeshtë kemi vendosur që dy – tre kategori, që eventualisht mund të jenë të dyshimta...!

Kemi vendosur një çelës, tha z. Dushi, që është diku rreth 2% që do të përzgjidhen sipas rastësisë për tu verifikohet dhe ne, rekomandojmë miratimin e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votimin Jashtë Kosovës. Pra, të gjithë qytetarët e Kosovës që do të aplikojnë për të votuar si votues nga jashtë në këto zgjedhje, nuk do ti nënshtrohen një verifikimi përmes thirrjeve telefonike, por vetëm rastet e dyshimta, dhe 2-i si përzgjedhje...

Vendimi që po e rekomandojmë, në këshillë është miratuar unanimisht...

Kreshnik Radoniqi: Së pari, po mendoj e votojmë “shfuqizimin e vendimit 44/41 të datës 11.01.2021”.

Kush është për ?

Miratohet.

Kreshnik Radoniqi: E hapi debatin! A ka dikush me diskutue rreth Udhëzimit Administrativ nr. 02/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votimin Jashtë Kosovës ?

Sami Kurteshi: Ne kemi diskutuar në këshill lidhur me këtë udhëzim, dhe kemi marrë vendim që me ndryshimet, sqarimet e bëra të shkoj përpara. Po ashtu, në kuadër të këtij udhëzim, unë kam bërë një propozim që e kemi lënë ta diskutojmë në KQZ. Kjo ka të bëjë me shtimin e një neni që unë e kam emërtuar “neni X”. Ky nen, ka të bëjë me aplikimin elektronik – on linë. Unë, kam bërë përpjekje që ta rregulloj këtë nen me 6 paragrafe, dhe këtu, çështja kryesore është që “formulari” të cilin ne e kemi shqyrtuar, ta ketë edhe këtë nen që e lejon aplikim elektronik ose on line të aplikuesve jashtë vendit.

Si bëhet kjo ? Kjo bëhet duke e futur në mënyrë elektronike formularin që e kemi miratuar sot, dhe janë dy formularë...Kjo, nga të gjitha mësimet e nxëna, nga përvoja, problemet që kanë dalë etj., ne e kemi kërkuar këtë disa herë. Me vota nuk është pranuar, por ne mendojmë që ky është një “mekanizëm” që e lehtëson punën deri në një përmasë të madhe pozitive...Pra, kjo e mënjanon koston fizike, e rritë sigurinë, dhe të dhënat janë të përputhshme me listën e votuesve, bashkë me “identitetin” e aplikuesve...

Ka pasur kundërshtime, tha z. Kurteshi që mendoj se nuk kan qenë të vlefshme. Pra, ky proces, është shumë më efikas se metodat e deritashme, dhe me kosto shumë më të lirë...Prandaj, unë propozoj që ky nen të futet në udhëzim...

Kreshnik Radoniqi: Ku është kundërshtimi, sipas asaj që po thoni...?

Sami Kurteshi: Ka qenë një kundërshtim që ligji e ndalon. Por, ligji nuk e ndalon sepse, vetë ligji i ka paraparë shprehimisht, tri forma: forma përmes postës elektronike ose imellit, faxit, dhe e postës fizike...! Ligji, meqë nuk e parasheh në këtë mënyrë, as nuk e ndalon...! Kundërshtimi tjetër, ka qenë “siguria”. Por, mëngoj që forma elektronike është më e sigurve sepse KQZ e ka serverin e tij, dhe mendoj format tjera janë më të cënueshme....Është përmendur edhe “integriteti” por, unë se kam kuptuar këtë kundërshtim...

Arianit Elshani: E para, diskutimi është jashtë rendit të ditës. Parimisht, kemi ra dakord që këtu në KQZ, të kemi një sistem të digjitalizuar si në departamente, në QNR...Pra, KQZ të digjitalizoj shumë procese të saj,

mirëpo këto bëhen duke pasur edhe një reformë zgjedhore...Ne, procesin e digjitalizimit e kemi futur edhe në raportin për Kuvend, sepse kjo edhe kërkohet...

Digjitalizimi, lehtëson shumë segmente, dhe njëkohësisht edhe procesin e votimit elektronik të diasporës për të votuar, mirëpo janë procese që duhet të kalojnë me ligj...

Pse them se ky nen i propozuar është jashtë këtij udhëzimi administrativ dhe nuk përkon me këtë propozim ? Sepse, bëhet fjalë për një udhëzim administrativ “për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë vendit”, dhe jo për identifikimin e tyre për regjistrimin e tyre, për procedurën dhe, është rregull e veçantë ajo që e rregullon këtë...

Pra, ky është operacion i veçantë, dhe duhet rregull e veçantë...Pra, kemi kërkuar edhe nga Sekretariati që ta ketë si orientim, sepse nuk jemi kundër.... aq më pak t’ia cenojmë dikujt të drejtën për të votuar...

Florian Dushi: Në parim, s’kemi qenë kundër por, siç u tha edhe më parë ne kishim pikë të rendit të ditë në këshill udhëzimin administrativ për verifikimin e aplikacioneve, që është vetëm një segment i procesit të votimit nga jashtë, prandaj kemi vlerësuar se çështja e ndërtimit eventual të një aplikacioni të veçantë, duhet të diskutohet në mënyrë të veçantë dhe në kuadër të rregullës zgjedhore...

Çështja e aplikacionit, nuk duhet të bëhet pjesë e udhëzimit, sepse është pjesë e rregullës zgjedhore pra, nëse ne pajtohemi si KQZ, ne mund ta obligojmë Sekretariatit që, për aq kohë sa i ka mbetur a mundet me e përgatitë një aplikacion, bashkë me referencat e tjera: shpenzimet, informimi etj.

Vlerësimi i këshillit, ishte se ky nen nuk e ka vendin te udhëzimi administrativ.

Alim Rama, tha se nëse aplikacioni nuk ka vend te k udhëzim administrativ, atëherë as neni 2 nuk ka vend në këtë udhëzim, se “neni 2”, e cek aplikimin përmes postës elektronike...! Nëse flasim vetëm për verifikimin, të koncentrohemi te verifikimi që sqarohet në nenin 3...

Në shtator të vitit të kaluar, kemi marrë një vendim nga Sekretariati se, është i gatshëm me e zhvillua këtë aplikacion... Mos të krijojmë huti, sepse imeli është një komunikim elektronik, pra ne jemi duke folur se a dëshiron KQZ me pasur një sistem të konsoliduar elektronik... Forma e këtillë, e lehtëson procesin, format e tashme, e rëndojnë procesin...

Ky aplikacion, ka qenë në plan të punës, madje edhe para vitit 2019...

Kreshnik Radoniqi: Si e shoh unë ? Aplikacioni, pikë së pari, ka të bëjë me verifikimin e aplikacioneve që na vijnë nga jasht, jo me aplikimin e votuesve...Nëse, ne e pranojmë këtë propozim, ne e tejkalojmë nenin

97... Unë po e shoh që edhe në rregullore e kemi një pikë të shtuar që, nuk e parasheh ligji që nënkupton se, edhe vetë rregullorja e tejkalon ligjin dhe nuk është në përputhje me vet ligjin...

Ligji, e kërkon aplikim vetëm përmes postes dhe faksit ! Pra, pa e dhënë dispozita ligjore, ne nuk mund të bëjmë ndërhyrje...pra, udhëzimi administrativ ka të bëjë me punën e Sekretariatit dhe ne nuk mund ta tejkalojmë ligjin...

Sami Kurteshi: Ne, nuk po e ndryshojmë asnjë rregull. Nëse ju po konstatoni se e kemi shkelur ligjin, sepse e kemi futur aplikimin përmes adresës elektronike (neni 2). Unë mendoj se ne nuk jemi duke e shkelur ligjin, por ne po fusim mjete, dhe puna e jonë është me ua lehtësuar të gjithë qytetarëve mundësinë e votimit... Unë e kam propozuar nenin që, pikërisht është në lidhje me nenin 2...

Pra, tha z. Kureshi, unë jam që t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet që i kemi në dispozicion...! Ne, nuk po e shkelim ligjin vetëm po përdorim mjete moderne, dhe kjo është vetëm një çështje teknike...

Ibrahmi Selmanaj: Mendoj se kemi diskutuar gjatë, dhe është mbërri konsensusi që ne jemi duke i marrë një varg masash që zgjedhjet t ë jenë të sigurta, dhe të mos ketë probleme...Ne, asnjë kundërshtim se kemi pasur ndaj propozimit të z. Kurteshi, por duhet ti shohim procedurat, rregullat...

Kreshnik Radoniqi: Unë, tani e hedh në votim...!

Miratohet udhëzimit administrativ nr. 02/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votimin Jashtë Kosovës me 6 vota për, dhe 3 vota abstenim.

4. Shyqrtimi dhe miratimi i formularëve për Regjistrim për Votimin Jashtë Kosovës:

Florian Dushi: Këshilli, ka diskutuar dy formularë që ndërlidhen me procesin e votimit të qytetareve tanë jashtë Kosovës:

- 1. Formulari për regjistrimin dhe aplikimin për votim jashtë Kosovës.*
- 2. Formulari i aplikimit për votim jashtë Kosovës.*

Ne, i kemi shqyrtuar këta formularë, kemi bërë propozime, kemi korrigjuar përmbajtjet e kaluara dhe kemi thënë se qytetarët që votojnë, nuk do të thirren të gjithë me telefon...Kemi thënë se, mund të thirret ndokush, sidomos në rastet kur dikush mund të jetë i dyshimtë, pastaj rastet kur dokumentet nuk janë të kompletuara...

I keni para jush formularët dhe, ne rekomandojmë për miratim.

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Florian Dushi.

Miratoohen këta dy formularë.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së:

Burim Ahmetaj: Nga mbledhjet e kaluara, është kërkuar nga ne që, tu drejtohem organizatave të jashtme për kompletimin e komitetit të Auditimit. Deri më tani, kemi pranuar dy konfirmime: një nga Ministria e Shëndetësisë dhe KPMM. Por, kemi ri konfirmimin nga KPMM se, nuk mund të na përkrahin dhe, tani e kemi vetëm një konfirmim. Pra, kemi tre anëtarë dhe, i mbetet KQZ –së se a, do ta themelojë komitetin me tre anëtarë...!

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Kurteshi** që tha se, duhet të bëhen përpjekje në vazhdimësi me organizatat e jashtme, sepse është kërkesë ligjore që ta formojmë këtë komitet...! Kreshnik Radoniqi, po ashtu tha se duhet të vazhdohet kontakti me institucionet e jashtme...

Alim Rama, propozoi që të votohen tre anëtarët e komitetit, dhe në ndërkohë, të vazhdohet me plotësimin me anëtarë të tjerë...

Diskutuan edhe: **Arianit Elshani, Burim Ahmetaj, Florian Dushi.**

Në fund, anëtarët e KQZ –së, miratuan vendimin për kandidatin e tretë – anëtarë të Jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së: znj. Kadrie Berisha, Udhëheqëse e Divizionit të Buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.

Fazli Stolla: Këshilli, ka mbajtur dy takime ku janë shqyrtuar dy tekste. Më datën 18 qershor ka shqyrtuar tekstin lidhur me informimin e subjekteve politike për afatin e aplikimit për certifikim. Afati i është: 17 qershor – 17 gusht 2021. Dhe me datën 30 qershor ka mbajtur takim tjetër ku ka shqyrtuar dokumentin lidhur me informimin për afatin për akreditim të vëzhguesve. U është bërë thirrje të gjithë faktorëve

relevant që të aplikojnë. Informacioni, është bërë në ueb faqen e KQZ-së, në rtk etj. Po ashtu, kemi kërkuar që në ueb faqen tonë, të ketë më shumë publikime, informacione etj.

7. Të ndryshme

Alim Rama, kërkoi që gjatë javës të trajtohet përsëri çështja e aplikimit të digjitalizuar të votimit jashtë Kosovës. Kisha kërkuar që kjo, të diskutohet si pikë e veçantë...

Florian Dushi, tha se ne kemi pasur konsideratë për kërkesën e Sami Kurteshit. Jam për, dhe Sekretariati të na njoftoj nëse mundet me ecë në këtë proces, pavarësisht se unë e kam konsideruar si një proces mjaft kompleks...

Unë, kam kërkesë që nëse ka mundësi që karriget ku ulemi, të ndërrohen...

Kreshnik Radoniqi: Kërkesa është bërë z. Dushi, presim...